

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar dhe auditimi
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I, Semestri II
Numri i orëve në javë:	3+0
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Salla S1
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Ass.Dr. Artor Nuhiu
Detajet kontaktuese:	artor.nuhiu@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<i>Kjo lëndë është e orientuar për nevojat e studentëve të drejtësisë duke i'u ofruar atyre njohuri themelore mbi raportimin financiar për kompanitë shërbyese, tregtare dhe prodhuese. Gjithashtu u ofron njohuri për rregullativën ligjore të raportimit financiar si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik, me sistemin e qeverisjes korporative, me ligjet themelore të cilat zbatohen në fushën e financave publike dhe sektorët tjerë. Qëllimi është që studentët të zhvillojnë aftësitë që të mund të regjistrojnë transaksionet e përgjithshme të kontabilitetit, të kuptojnë dhe të interpretojnë pasqyrat financiare themelore dhe përdorimin e informacionit financiar për të ndihmuar në marrjen e vendimeve më të mira të biznesit. Ti identifikojnë Ligjet dhe Rregulloret të cilat duhet të zbatohen me rastin e trajtimit të ngjarjeve afariste në të gjithë sektorët, si dhe ti ndjekin Standardet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare me rastin e përpilimit të raporteve financiare dhe kontrollit apo auditimit të atyre raporteve.</i>
Qëllimet e lëndës:	<i>Raportimi financiar është një mekanizëm kyç në vendimmarrjen e biznesit. Ka dy synime për studentët e drejtësisë në këtë lëndë. Qëllimi primar është që studentët të bëhen përdorues të informuar të informacionit të pasqyrave financiare. Deri në përfundim të lëndës, studentët duhet të jenë në gjendje të analizojnë pasqyrat financiare, shënimet shpjeguese dhe shpalosjet e tjera të korporatave, të interpretojnë artikuj nga shtypi dhe publikime të tjera të bizneseve dhe të kuptojnë raportet e analistëve. Qëllimi sekondar është të sigurohen se do të jenë të familjarizuar me</i>

	<p><i>mekanikën kryesore të raportimit financiar. Në përfundim të lëndës, studentët duhet të jenë në gjendje të përgatisin pasqyra financiare që pasqyrojnë një gamë të gjerë transaksionesh financiare. Kuptimi i ndikimit të transaksioneve në pasqyrat financiare është thelbësor për përgatitjen e planeve të biznesit, parashikimin e performancës financiare, buxhetimin dhe vlerësimin e implikimeve të transaksioneve të propozuara në pasqyrat financiare. Këto aftësi do t'ju japin një bazë solide për lëndë të tjera bazë dhe zgjedhore.</i></p>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p><i>Pas përfundimit të kësaj lënde, studentit duhet të ketë njohuri dhe aftësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Përshkruajnë qëllimin kryesor të raportimit financiar dhe rolin e tij për organizatat biznesore dhe jobiznesore.</i> • <i>Përmbledhë parimet themelore të kontabilitetit, Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) në mënyrë që të regjistroj informacionin financiar dhe përgadisë pasqyrat financiare mbi bazat e këtyre parimeve dhe supozimeve.</i> • <i>Për tu përcjell studentëve rëndësin e raportimit financiar dhe pasqyrat financiare për menaxhimin e biznesit.</i> • <i>Të ndihmoj studentët për të kuptuar se si vendimet financiare, investuese dhe operative reflektohen nga pasqyrat financiare.</i> • <i>Të inkurajoj dhe zhvilloj studentët për mendimin kritik në inkorporimin dhe orinetimin e marrjes së vendimeve të qëndrueshme.</i> 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	15	30
Ushtrime në teren			
Kollokfieme,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	8	3	24
Përgaditja përfundimtare për provim	7	2	14
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	2	10

Projektet,prezentimet ,etj.			
Totali			125 orë
Metodologjia e mësimëdhënies:	<p>Lënda do të organizohet në formë të ligjeratave, diskutimeve dhe konsultimeve. Studentët duhet të jenë pjesëmarrës aktivë të procesit mësimor.</p> <p>Mësimi aktiv kërkon që studentët të reflektojnë mbi gjërat që diskutohen e jo të jenë pranues pasivë të informatave që u jepen. Ata janë të inkurajuar që të shtrojnë pyetje. Nga studentët paraprakisht do të kërkohet leximi dhe thellimi në literaturën relevante për temat e specifikuar të lëndës.</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i studentëve konsiston në dy metoda:</p> <p>1. Vlerësimi i vazhdueshëm: Studentët do të vlerësohen gjatë gjithë semestrit përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <u>Vlerësimi fundsemestral përmes testit: 90%</u> ▪ <u>Pjesëmarrja e rregullt dhe anqazhimi në diskutime në liqjërata: 10%.</u> <p>2. Provimi final: Studentët që nuk kanë arritur të kalojnë me sukses vlerësimin e vazhdueshëm ose nuk kanë marrë pjesë në të, duhet t'i nënshtrohen provimit final gjatë afatit të provimeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <u>Provimi final:</u> vlerësohet me 100%. <p>Shënim: Studentët që zgjedhin/kalojnë me sukses vlerësimin e vazhdueshëm dhe janë të kënaqur/pranojnë notën e kollokfiomit lirohen nga pjesëmarrja në provimin final.</p>		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rrustem Asllanaj, Kontabiliteti Financiar, 2010, Edicion i parë. ISBN 9789951001175. 2. Greg F. Burton, Eva K. Jermakowicz - International Financial Reporting Standards: A Framework-Based Perspective, Routledge, 2013. 3. Hennie Van Greuning - International Financial Reporting Standards: A Practical Guide, World Bank Publications, 2006. 4. Brian Brinig, Finance and Accounting for Lawyers, 2nd Edition, 2020. Business Valuation Resources, LLC. 5. Christopher Mohr, Basics of Accounting for Lawyers, 2021. ISBN: 978-1-4024-3880-6. 6. Rod Monger, Financial Accounting, A global Approach, 2010. 1st Edition. ISBN 9780470518403 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligji nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim. 2. Ligji nr. 03/L-222 për administratën tatimore dhe procedurat. 		

	<p>3. <i>Ligji nr. 06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave.</i></p> <p>4. <i>Ligji nr. 05/L-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar.</i></p> <p>5. <i>Ligji nr. 05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale.</i></p>
Plani i dizajnuar i mësimimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Ligjërata hyrëse - prezantimi i syllabusit të lëndës
Java e dytë:	Roli i kontabilitetit për biznesin dhe raportimi financiar; Përdoruesit e informatave të raportimit financiar.
Java e tretë:	Korniza rregullative e raportimit financiar dhe pasqyrave financiare; Parimet, Supozimet dhe Kufizimet e Kontabilitetit.
Java e katërt:	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF); Organizatat profesionale ndërkombëtare të kontabilitetit.
Java e pestë:	Procesi i regjistrimit të informacionit financiar; Regjistrimi i transaksioneve kontabël; Sistemi i regjistrimit të dyfishtë të transaksioneve.
Java e gjashtë:	Pasqyrat financiare; Pasqyra e pozitës financiare (Balanci i gjendjes); Komponentet e bilancit të gjendjes; Pasuritë, Detyrimet dhe Kapitali (Ekuiteti).
Java e shtatë:	Pasqyrat e të ardhurave; Formatet e pasqyrës së të ardhurave.
Java e tetë:	Pasqyra e ndryshimeve në kapital (ekuitet); Pasqyrat e rrjedhave të parasë së gatëshme.
Java e nëntë:	Procesi i regjistrimeve rregulluese; Shtyrjet (Deferrals) dhe Rritjet (Accruals); Të hyrat e shtyera (të pafituara).
Java e dhjetë:	Përpilimi i pasqyrave financiare dhe mbyllja e librave.
Java e njëmbëdhjetë:	Definimi dhe klasifikimi i inventarit të mallit (stoqeve); Sistemi kontinuel dhe periodik i regjistrimit të inventarit të mallit; Blerjet dhe shitja e mallit.
Java e dymbëdhjetë:	Pasuritë afatgjate dhe afatshkurte; Zhvlerësimi i pasurive; Metodot e zhvlerësimit; Detyrimet afatgjate dhe afatshkurte.
Java e trembëdhjetë:	Financimi i korporatave përmes emitimit të aksioneve; Llojet e aksioneve; Kontabiliteti për aksionet e shitura (emetuara).
Java e katërmëdhjetë:	Të kuptuarit e auditimit si proces, Çka është auditimi, Llojet e auditimit, Ilustrimi i llojit standard të opinionit të auditimit dhe pjesët e tij, Llojet tjera të auditimit, rëndësia e auditimit.
Java e pesëmbëdhjetë:	<i>Vlerësimi fundsemestral përmes testit</i>
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Sjelljet e poshtëshënuara janë në kundërshtim me politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Vonesa në ligjerata dhe ushtrime;</i> • <i>Lëshimi i sallës gjatë ligjeratave ose ushtrimeve (pa arsyeje të nevojshme);</i> • <i>Tregimi i shenjave të qarta të mosinteresimit dhe të folurit të pandërprerë ose formave tjera të sjelljes që pengojnë procesin e rregullt të mësimimit;</i> • <i>Mbajtja e telefonit celular të hapur gjatë ligjeratave ose ushtrimeve, do të rezultojnë me humbje të pikëve për shkak të sjelljes joprofesionale.</i> 	

Shkelja e integritetit akademik përfshin një ose më shumë nga veprimet në vijim:

- *Kopjimi gjatë provimit ose testit;*
- *Shfrytëzimi i shenimeve ose librave të palejuara gjatë testit ose provimit;*
- *Shkëmbimi i informatave me një student tjetër gjatë provimit;*
- *Dhënja e deklaratave të rrejshme për të arsyetuar dikë nga mësimi, ushtrimi apo provimi.*